



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*

**AKADEMIA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE**  
**KOSOVSKA AKADEMIJA ZA JAVNU BEZBEDNOST**  
**KOSOVO ACADEMY FOR PUBLIC SAFETY**

# **STRATEGJIA ZHVILLIMORE DHE PLANI I VEPRIMIT 2019 – 2022**

*Vushtrri, 2019*



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria-Vlada-Government**

*Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrasnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs*  
*Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademia za Javnu*  
*Bezbednost/Kosovo Academy for Public Safety*

Në mbështetje të nenit 14 paragrafit 1, nën-paragrafi 1.2 si dhe 1.7 të Ligjit Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet Strategjia Zhvillimore dhe Plani i Veprimit për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike për vitin 2019-2022.
2. Obligohen të gjitha njësitë organizative pranë AKSP-së për zbatimin e strategjisë nga pika 1 e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Datë: 28.02.2019

Ismail Smakiqi



Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së



Vendimi lu dërgohet:

- Udhëheqësve të njësive organizative dhe;
- Arkivit të AKSP-së.

## PËRMBAJTJA

---

LISTA E SHKURTESAVE .....	4
FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AKSP-së .....	5
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	6
II. HYRJE.....	9
III. HISTORIKU DHE MANDATI.....	10
IV. MISIONI DHE VIZIONI.....	12
V. VLERAT .....	12
VI. PARIMET.....	13
VII. METODOLOGJIA.....	14
VIII. SFONDI.....	16
IX. OBJEKTIVAT.....	17
X. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI .....	22
XI. PLANI I KOMUNIKIMIT TË STRATEGJISË.....	23
XII. PLANI I VEPRIMIT .....	23

## LISTA E SHKURTESAVE

<b>AKSP</b>	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
<b>AEPC</b>	Asociacioni i Kolegjeve Policore Evropiane
<b>AKA</b>	Agjencia e Kosovës për Akreditim
<b>AKK</b>	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
<b>FSP</b>	Fakulteti i Sigurisë Publike
<b>ICITAP</b>	Trajnimi Ndërkombëtar i Hetimeve Kriminale Përkrahja Programore
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>BE</b>	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
<b>Projekti Binjakëzimit</b>	Projekti i fituar nga AKSP në kuadër të IPA II - Programi vjetor për Kosovën, "Përkrahja e mëtejshme e arsimit në siguri publike në Kosovë", projekt ky i financuar nga BE-ja.
<b>IHZH</b>	Instituti për Hulimtim dhe Zhvillim
<b>ISP</b>	Institucionet e Sigurisë Publike që veprojnë në AKSP
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>IPK</b>	Inspektorati Policor i Kosovës
<b>AME</b>	Agjencioni i Menaxhimit Emergjentë
<b>SHKK</b>	Shërbimi Korrektues i Kosovës
<b>SHSK</b>	Shërbimi Sprovues i Kosovës
<b>DK</b>	Dogana e Kosovës
<b>MPB</b>	Ministria e Punëve të Brendshme
<b>Palët e interesit</b>	Institucionet e Sigurisë Publike, duke mos u kufizuar vetëm në: Policia e Kosovës (PK), Dogana e Kosovës (DK), Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK), Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK), Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) dhe Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME)
<b>Vijues</b>	Personat të cilët vijnë trajnime dhe arsim të lartë në Akademi
<b>IADLES</b>	Asociacionit Ndërkombëtar i Drejtorëve të Standardeve dhe Trajnimit në Zbatimin e Ligjit në SHBA
<b>Partnerët Ndërkombëtar</b>	Partnerët e përhershëm që veprojnë dhe bashkëpunojnë me AKSP-në si ICITAP, OSBE,
<b>Bordi i AKSP-së</b>	Organ i cili vepron në kuadër të AKSP-së i cili vendos për standardet minimale profesionale, politikat e trajnimit dhe edukimin e specializuar dhe të avancuar për ASP-të.
<b>Këshilli FSP-së</b>	Organi më i lartë akademik i FSP-së i cili vendos për të gjitha çështjet e rëndësishme në fushën e mësim, kërkimit dhe hulumtimit shkencor

## FJALA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AKSP-së

---



Kam kënaqësinë të paraqes Strategjinë Zhvillimore dhe planin e veprimit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për vitet 2019-2022.

Kjo është strategjia e dytë e AKSP-së, pas strategjisë së parë për vitet 2014-2018, që i mundësuan AKSP-së të tejkalojë me sukses sfidat e periudhës së konsolidimit të saj pas hyrjes në fuqi të Ligjit të AKSP-së.

Strategjia zhvillimore 2019-2022 paraqet një mundësi për t'i dhënë orientim të ri zhvillimit të AKSP-së, duke paraqitur ide të reja në përputhje me kërkesat e kohës dhe duke reflektuar mbi sfidat e përballura gjatë zbatimit të strategjisë paraprake. Në strategjinë e re janë përcaktuar prioritetet për katër vitet e ardhshëm të punës së AKSP-së me fokus në çështjet kryesore si vijon: trajnimet, arsimit i lartë, hulumtimi, sigurimi i cilësisë, burimet njerëzore, kapacitetet Infrastrukturore, proceset e punës si dhe bashkëpunimit me palët e interesit vendor dhe ndërkombëtar.

Duke pasur një mision të qartë, AKSP është e përkushtuar në arsimimin e zbatuesve të ligjit në mënyrë që të pajisë dhe avancojë njohuritë dhe shkathtësitë e duhura për të gjithë pjesëtarët e Institucioneve të sigurisë publike që u shërbejnë qytetarëve të Republikës së Kosovës për të qenë të sigurt në ambientet ku jetojnë dhe veprojnë.

Sfidat përballuese me dukuritë negative kërkojnë që të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit të jenë fleksibile dhe në hap me kohën, andaj aktivitetet e AKSP-së janë të fokusuar në drejtim të ngritjes së kapaciteteve profesionale përmes ofrimit të trajnimeve, arsimit të lartë dhe hulumtimeve me qëllim të kryerjes së mandatit të saj ligjor.

*Andaj në emër të AKSP-së shfrytëzoj rastin që gjithashtu të shpreh falënderimin e sinqertë për të gjithë ata që na ndihmuan ndër vite dhe besuan në punën tonë, e në veçanti Institucionet e Sigurisë Publike, ICITAP-in, OSBE-në, Zyrën e Bashkimit Evropian në Prishtinë dhe partnerët tjerë.*

Sinqerisht,

**Ismail Smakiqi**

**Drejtor i Përgjithshëm i AKSP-së**

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

---

Ky dokument është bazë për zhvillimin Institucional të AKSP-së. Krijimi i këtij dokumenti ka filluar qysh në takimet e para me ekspertët e projektit të Binjakëzimit në muajin shkurt 2018. Ky fokus grup ka zhvilluar takime të shumta rreth formësimit të ideve dhe politikave strategjike të Institucionit.

Po ashtu është themeluar grupi bërthamë nga njësitë e AKSP-së, të cilat kanë rekomanduar dhe propozuar objektiva strategjike dhe specifike. AKSP është mirënjohëse ndaj institucioneve të sigurisë dhe partnerëve ndërkombëtare për rolin e rëndësishëm që ato kanë luajtur në shumë procese dhe në zhvillimin e këtij dokumenti.

AKSP strategjinë e saj të parë për zhvillimin e Institucionit e ka miratuar në dhjetor të vitit 2013 e cila ka mbuluar një periudhë pesë (5) vjeçare 2014-2018. Bazuar në raportet e hartuar për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të saj, janë arritur rezultate konkrete dhe të matshme.

Me qëllim të avancimit edhe më tutje të Institucionit është hartuar ky dokument strategjik përmes së cilës AKSP-ja merr seriozisht përgjegjësinë e ofrimit të shërbimeve të arsimit dhe trajnimit si faktor kyç i sigurisë publike.

Strategjia zhvillimore institucionale e AKSP-së 2019-2022 është një dokument i cili është hartuar duke u bazuar në analizimin e gjendjes aktuale dhe si rezultat janë përcaktuar mekanizmat kyç për avancimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të AKSP-së.

Trajnimi dhe arsimimi i zyrtarëve të sigurisë si faktor kyç në ngritjen e sigurisë publike është sfidë me shumë dimensione. Andaj përmes kësaj strategjie synojmë t'i avancojmë njohuritë dhe shkathtësitë e duhura për të gjithë pjesëtarët e Institucioneve të sigurisë publike duke u bazuar në **praktikat** dhe **standardet** më të mira vendore dhe ndërkombëtare në fushën e trajnimit dhe arsimimit.

AKSP-ja po krijon standarde dhe mekanizma për ngritjen e cilësisë në politikat e trajnimit dhe arsimimit për zyrtarët e sigurisë publike falë bashkëpunimit dhe anëtarësimit në shumë organizata ndërkombëtare, akreditimeve vendore dhe ndërkombëtare, implementimit të dy projekteve të Binjakëzimit nga Bashkimi Evropian, përkrahjes së vazhdueshme të partnerëve strategjik si ICITAP dhe OSBE.

AKSP-ja synon çdo herë ti përcjellë dhe të jetë në hap me trendët e zhvillimit në fushën e sigurisë publike duke adaptuar mekanizmat e saj me qëllim të ngritjes së vazhdueshme profesionale të zyrtarëve të sigurisë publike. Strategjia e AKSP-së është adaptuar konformë kërkesave dhe nevojave të Institucioneve të Sigurisë Publike.

Ky dokument strategjik përmes planit të veprimit ka përcaktuar objektivat strategjike, specifike, mekanizmat, metodat, rezultatet dhe mënyrën me qëllim të implementimit të një politike efektive që do të ndërmarrin në katër vitet e ardhshme (2019-2022).

AKSP-ja realizon misionin e saj përmes qëllimeve strategjike të cilat mund të përmbliken si në vijim:

- Zhvillimi i kapaciteteve për Institucionet e sigurisë publike duke ofruar kompetencën e nevojshme për të reaguar ndaj sfidave vazhdimisht të ndryshueshme;
- Ngritja e cilësisë për shërbimet e ofruara duke u bazuar në standardet dhe kriteret e akreditimeve vendore dhe ndërkombëtare;
- Avancimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar me qëllim të krahasimit dhe shkëmbimit të praktikave më të mira;
- Krijimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore që plotëson nevojat e zbatimit të misionit AKSP-së;
- Avancimi i shërbimeve, pajisjeve dhe infrastrukturës konformë standardeve ndërkombëtare dhe nevojave trajnuese dhe arsimore.

Objektivat e Strategjisë burojnë nga qëllimet e lartcekura, analizën e përvojës së kaluar dhe gjendjes aktuale. Me qëllim të arritjes së orientimit strategjik kemi përcaktuar **objektivat e përgjithshme strategjike** e të cilat janë përkufizuar si më poshtë:

- 1) *Ofrimi i trajnimeve profesionale, avancuara dhe të specializuara për institucionet e sigurisë publike në përputhje me standardet vendore dhe ndërkombëtare të akreditimit;*
- 2) *Fuqizimi i arsimit të lartë në siguri publike;*
- 3) *Zhvillimi i profilit hulumtues në shërbim të sigurisë publike;*
- 4) *Implementimi i politikave të sigurimit të cilësisë sipas standardeve bashkëkohore*

- 5) *Ngritja dhe përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, kapaciteteve infrastrukturore dhe proceseve të punës*
- 6) *Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me palët e interesit vendore dhe ndërkombëtare*

Më qëllim të përmirësimit, AKSP-ja ka paraparë shumë aktivitete të cilat do të ndikojnë në përmirësimin apo ndryshimin pozitiv qoftë të programeve apo Institucionit dhe bazohet në dokumentet e tjera të rëndësishme si vijon:

- Programi i Qeverisë 2017 – 2021;
- Direktivat e MPB-së;
- Rekomandimet dhe standardet nga raportet mbi vlerësimin e akreditimit vendor dhe ndërkombëtar të AKSP-së të hartuara në periudha të ndryshme kohore, të kryera nga AAK-ja, AKK-ja dhe IADLEST-i;
- Analiza e nevojave dhe rekomandimet e institucioneve të sigurisë publike;
- Rekomandimet e partnerëve ndërkombëtar;
- Rekomandimet e Projektit të Binjakëzimit;
- Rekomandimet e Institucioneve, OJQ-ve tjera relevante nga fusha e sigurisë.

Të gjitha këto objektiva dhe synime strategjike do të konkretizohen duke përcaktuar qartë planin e veprimit si pjesë përbërëse të dokumentit i cili parasheh orientimin dinamik dhe rezultatin konkret për secilin aktivitet. Anëtarët e personelit të AKSP-së do të shfaqin nivel të lartë të profesionalizmit dhe do të jenë tërësisht të përkushtuar për vlerat organizative të AKSP-së dhe për parimin e përmirësimit të vazhdueshëm.



## II. HYRJE

---

Strategjia zhvillimore e AKSP-së është si rezultat i punës të madhe dhe të arriturave në bashkëpunim të zyrtarëve të AKSP-së, ISP-ve dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë si ICITAP, OSBE-së dhe Projektit të Binjakëzimit.

AKSP-ja, përmes kësaj strategjie, dëshiron të hap rrugë drejt një Akademie moderne e cila synon që duke u mbështetur në përmirësimet e vazhdueshme dhe cilësi të lartë të trajnimeve dhe arsimit të lartë të ofroj nivel të lartë të kompetencave për autoritetet e zbatimit të ligjit për të ju përgjigjur ndryshimit të vazhdueshëm të sfidave.

Misioni ynë është i qartë: institucioneve të sigurisë publike të Kosovës ju nevojitet ngritje e vazhdueshme profesionale të kuadrove të përgatitur dhe të aftësuar. Ata do të ofrojnë siguri për të gjithë qytetarët e vendit tonë.

Kjo strategji buron nga Ligji Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike e cila është e lidhur ngushtë edhe me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017 - 2021 dhe Programin e MPB-së 2017-2021 nga fusha e sundimit të ligjit. Akademia si themel i aftësimin të zyrtarëve të sigurisë aspiron që përmes zhvillimeve shkencore, hulumtimit, avancimit të programeve studimore dhe trajnuese dhe bashkëpunimit ndërkombëtar të arrijë zbatimin e politikave dhe prioritetëve të parapara.

Në fund, falënderojmë të gjithë anëtarët dhe ekspertët e Grupit Punues, përkushtimi dhe puna shumë e madhe e të cilëve ka bërë të mundur ta kemi në duart tona këtë Strategji Zhvillimore për katër vitet e ardhshme 2019-2022. Mbetet që në të ardhmen, të gjithë palët e interesit të AKSP-së të japin kontributin e tyre maksimal për ta implementuar këtë dokument dhe vizion strategjik, gjë që mund të arrihet vetëm duke forcuar dhe avancuar bashkëpunimin që tashmë e kemi.

### III. HISTORIKU DHE MANDATI

---

#### **Historiku**

AKSP u themelua në dhjetor të vitit 2011 me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike sipas të cilit AKSP është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Prej vitit 1999 e deri më 2006 institucioni është quajtur Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK) dhe është menaxhuar nga OSBE-ja.

Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH) u themelua në vitin 2008 si agjenci ekzekutive në kuadër të MPB -së, e cila është edhe paraardhëse e AKSP së.

Gjatë viteve 2012/2013, në kuadër të projektit të binjakëzimit “Përmirësimi i arsimit në sektorët e rendit dhe sigurisë publike”, AKSP ka hartuar programin studimor Bachelor i cili i plotëson kërkesat e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare dhe në vitin 2014 është akredituar nga Agjencia e Kosovës për Akreditim.

Po ashtu janë validuar programet trajnuese profesionale për institucionet e sigurisë publike në vitin 2018 nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit.

AKSP ka përfunduar strategjinë e parë zhvillimore dhe planin e veprimit 2014-2018 në bazë të cilës ka arritur rezultate të dukshme.

Në vitin 2018, AKSP është akredituar nga Institucioni i IADLES (Asociacionit Ndërkombëtar i Drejtorëve të Standardeve dhe Trajnimit në Zbatimin e Ligjit në SHBA) si Institucioni i parë në botë jashtë SHBA-ve.

#### **Mandati**

AKSP në bazë të ligjit Nr. 04/L-053 është përgjegjëse për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit dhe të arsimit të lartë, si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike. AKSP i ofron shërbimet e lartpërmendura për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në:

- Policinë e Kosovës;
- Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Doganat e Kosovës;
- Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave;
- Inspektoratin e Policisë së Kosovës, dhe
- Shërbimin Sprovues të Kosovës.

Funksionet e AKSP-së janë:

- zhvillimin e kurrikulave specifike dhe ofrimin e trajnimeve themelore, të avancuara dhe të specializuara;
- zhvillimin e kurrikulave dhe ofrimin e trajnimeve edhe arsimit të lartë në fushën e sigurisë publike përmes programeve të akredituara nga ana e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve apo Agjencisë Kosovare për Akreditim;
- funksionon si institucion kërkimor në sferën e sigurisë publike, duke përfshirë por pa u kufizuar në hulumtime në fushën e zhvillimit të trajnimeve dhe arsimit të lartë për siguri publike;
- përgatit dhe trajnon, por pa u kufizuar në instruktorët e Agjencive të Sigurisë Publike dhe të Akademisë;
- ofrimin e shërbimeve mbështetëse për nevojat e trajnimit dhe arsimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në infrastrukturën fizike, teknologjinë informative dhe logjistikën;
- koordinimin e programeve të donatorëve për trajnimin, arsimimin dhe zhvillimin në fushën e sigurisë publike;
- kontrollin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë, aprovimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve trajnuese dhe titujve;
- mban të dhëna për trajnime dhe programe që realizohen në akademi;
- shqyrton dhe vlerëson periodikisht nevojat e institucioneve të sigurisë;
- bashkëpunon me institucionet tjera;
- Akademia e Kosovës për Siguri Publike mund të bashkëpunojë me Organizata ndërkombëtare dhe me institucione edukative në fushën e sigurisë, për të mundësuar lëvizjen e studentëve dhe trajnuesve në pajtim me ligjin në fuqi, apo me marrëveshjet ndërkombëtare, nënshkrues i të cilave është shteti i Kosovës;
- çdo trajnimi në Akademi, qoftë bazik qoftë të avancuar, Akademia jep vlerësime dhe preferenca për sistemime dhe avancime në detyrë, lidhur me performancën e vijuesit të treguar gjatë trajnimit, kur ketë e kërkojnë nevojat e institucioneve të sigurisë;
- me qëllim të avancimit të planeve dhe programeve të trajnimit, Akademia bënë testime, anketa, sondazhe dhe metoda tjera të mbledhjes së informatave për verifikimin e njohurive dhe shkathtësive të marra në Akademi dhe në punën e përditshme të institucioneve të sigurisë.

## IV. MISIONI DHE VIZIONI

---

### Misioni

Akademia ofron shërbime me cilësi të lartë të trajnimit, arsimit, kërkimit dhe zhvillimit në fushën e sigurisë publike.

### Vizioni

Në vitin 2022 AKSP-ja do të jetë Qendër e Ekselencës për Siguri Publike në Kosovë.

## V. VLERAT

---

Strategjia Zhvillimore e AKSP-së bazohet në këto vlera:

- 1) **Ndershmëria** – Nga secili anëtar i AKSP-së pritet të veprojë ndershmërisht në aspektin e punës dhe në jetën private. Kjo është më se e nevojshme dhe e domosdoshme për të bërë të mundshme dhe të realizueshme që AKSP të bëhet model i institucioneve publike. AKSP po ashtu në mënyrë të dukshme do të demonstrojë ndershmëri në proceset vendimmarrëse të saj.
- 2) **Transparenca** – Të gjitha proceset e AKSP-së: planifikimet, vendimmarrjet, vlerësimet, raportimet dhe të arriturat duhet të jenë tërësisht transparente për të gjithë palët e interesit në theks të strukturës, argumenteve dhe përgjegjësisë.
- 3) **Përgjegjësia** – AKSP fuqimisht demonstroi se do të mbajë përgjegjësi të plotë për nivelin e kompetencës së të diplomuarve. Brenda AKSP-së, secili anëtar i saj do të bartë dhe mbajë përgjegjësi për rezultatet të cilat rrjedhin nga veprimet dhe vendimet e tyre.
- 4) **Etika profesionale** – AKSP vë theksin mbi rëndësinë thelbësore në angazhimin e saj të të gjitha nivelet e arsimit, të praktikave më të mira profesionale dhe vlerat organizative. AKSP si institucion do të jetë shembull në këtë aspekt.
- 5) **Diversiteti** – AKSP është e përkushtuar për të njohur, vlerësuar dhe respektuar ndryshimet e të tjerëve dhe kulturat e tyre si një mjedis që promovon dhe feston arritjet individuale dhe kolektive.

## VI. PARIMET

---

Objektivat e parapara në Strategjinë Zhvillimore të AKSP-së udhëhiqen nga parimet vijuese:

1. **Parimi i ligjshmërisë** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë duhet të kryejnë të gjitha punët dhe përgjegjësitë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
2. **Parimi i profesionalizmit** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë duhet të veprojnë në mënyrë profesionale në ushtrimin e detyrave të tyre.
3. **Parimi i efikasitetit** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë duhet të organizojnë punën e tyre të përditshme me korrektësi, përpikshmërisë dhe efikasitet.
4. **Parimi i trajtimit të barabartë dhe i mos diskriminimit** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë duhet të respektojnë dinjitetin dhe barazinë e të gjithëve, pa asnjë dallim apo diskriminim të çfarëdo lloji.
5. **Parimi i respektimit** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë duhet të jenë të sjellshëm dhe ndershëm duke respektuar integritetin dhe personalitetin e njëri-tjetrit.
6. **Parimi i shmangies së konfliktit të interesave** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzojnë asnjëherë pozitën për interesat e tyre private.
7. **Parimi i konfidencialitetit** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të tyre të punës dhe të mos e përdorin një informacion të tillë për qëllime të tjera.
8. **Parimi i objektivitetit** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë nuk duhet të niset nga paragjykimi, favorizimi, apo nga ndikime të tjera, që mund të vënë në rrezik objektivitetin e tij.
9. **Parimi i zhvillimit** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë duhet të jenë të hapur për zhvillimin e qëndrueshëm dhe gatishmërinë për të kontribuar në këtë proces.
10. **Parimi i vazhdueshmërisë** - Për arritjen e synimeve të kësaj Strategjie Zhvillimore dhe Plani të Veprimit, kërkohet angazhim i vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës i të gjithë institucioneve dhe aktorëve relevantë.
11. **Parimi i paanshmërisë** - Personeli, vijuesit dhe personat e tjerë nuk duhet të jenë të njëanshëm, që do të thotë të kenë një predispozitë në favor të një rezultati të caktuar gjatë vlerësimit të një situatë, duke shkaktuar si pasojë një dëm të pajustificueshëm për interesin e përgjithshëm ose për të drejtat e palëve të tjera të interesuara.

## VII. METODOLOGJIA

Strategjia Zhvillimore e AKSP-së është bazuar në parimet që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, legjislacioni në fuqi si dhe në instrumentet ndërkombëtare. Strategjia e AKSP-së është bazuar edhe në praktikat më të mira të institucioneve të akredituara në fushën e sigurisë publike, duke aplikuar standardet më të avancuara ndërkombëtare.

Procesi i planifikimit strategjik ka përfshirë konsultime gjithëpërfshirëse me palët e interesit, institucionet tjera qeveritare të Kosovës dhe partnerët vendor dhe ndërkombëtarë.

Metodologjia e hartimit të strategjisë ka përfshirë:

- Studime kualitative nëpërmjet fokus grupeve të caktuara në projektin e Binjakëzimit;
- Grumbullim të literaturës dhe materialit të dokumentacionit brenda AKSP-së;
- Studime krahasuese mes gjendjes aktuale, arritjeve dhe objektivave për të ardhmen;
- Vizitat studimore të realizuara;
- Konferencat shkencore të organizuara në AKSP dhe Institucione të ngjashme.
- Rekomandimet e ekspertëve të akreditimeve vendore dhe ndërkombëtare;
- Raporti i fizibilitetit për studime master etj.

Po ashtu me rastin e hartimit të kësaj strategjia sipas fazave të ndryshme janë krijuar grupe të ndryshme të cilët kanë kontribuar në faza të ndryshme të hartimit të këtij dokumenti si vijon:



- **Fokus grupi** – i cilin në përbërje ka pasur Drejtorin e Përgjithshëm, zyrtarët e planifikimit strategjik, zyrtarët për marrëdhënie me jashtë dhe ekspertët e Projektit të Binjakëzimit të cilët kanë zhvilluar të gjitha takimet e komponentës së planifikimit strategjik .
- **Grupi Bërthamë** – i cila ka qenë i përbërë nga udhëheqësit e të gjitha njësive që veprojnë në AKSP dhe kanë përgatitur propozimet sipas fushave përkatëse.
- **Grupi gjithëpërfshirës** – i cili është përbërë nga përfaqësuesit e AKSP-së dhe përfaqësuesit e ISP-ve (Policia e Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Agjencioni i Menaxhimit Emergjent) si dhe partnerët tanë strategjik ndërkombëtar si ICITAP, OSBE dhe Projekti i Binjakëzimit .

Po ashtu në AKSP janë zhvilluar takime të shumta ku janë të përfshirë akterët e ndryshëm nga fusha e sigurisë publike dhe arsimore, nga të cilat takimeve janë identifikuar dhe prezantuar rekomandime të ndryshme e të cilat janë inkuorporuar në këtë dokument.

Disa prej takimeve që janë përfshirë shumë institucione kanë qenë takimet e rregullta të Komitetit Drejtues të Projektit të Binjakëzimit “Përkrahja e mëtejshme e arsimit në siguri publike në Kosovë” ku janë diskutuar çështjet dhe rezultatet në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të arsimit të lartë. Ky komitet është përbërë nga shumë përfaqësues të Institucioneve si vijon: Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Integritimit Evropian, përfaqësuesit e gjashtë institucioneve të sigurisë publike (Policia e Kosovës, Inspektorati Policor i Kosovës, Dogana e Kosovës, Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Sprovues i Kosovës), Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Zyra E BE-së në Kosovë, ICITAP, Misioni i OSBE-së në Kosovë si dhe Këshilltarët rezident të Projektit.

Po ashtu funksionon edhe Bordi i AKSP-së me përbërje nga udhëheqësit e Institucioneve të Sigurisë i cili mbanë minimumi katër (4) takime vjetore.

Këshilli i FSP-së i cili ka zhvilluar afër 60 takime në përbërjen e cilat janë profesorët, studentët dhe Menaxhmenti i AKSP-së.

Takimet e Grupeve punuese - Propozimet dhe rekomandimet e pjesëmarrësve të grupit punues janë diskutuar dhe përfshirë në Strategji.

## VIII. SFONDI

---

AKSP është institucion i formuar me Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

AKSP ofron trajnime dhe arsim të lartë për të gjitha institucionet e sigurisë publike por pa u kufizuar vetëm në:

- Policinë e Kosovës;
- Shërbimin Korrektues;
- Shërbimin Sprovues;
- Doganën e Kosovës;
- Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;
- Inspektoratin Policor të Kosovës

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 04/L-054 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, AKSP i është nënshtruar një transformimi, si në aspektin funksional, po ashtu edhe në atë organizativ. Aspekti funksional lidhet me atë se tani në kuadër të funksioneve të AKSP-së përveç funksionit mbështetës, teknik dhe administrativ, kemi një fuqizim të kompetencave në fushën e ofrimit të trajnimeve si dhe arsimit të lartë.

AKSP-ja tashmë ka përmbyllur dy projekte të Binjakëzimit si donacion nga BE-ja si dhe ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione të ngjashme në regjion si Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi si dhe me disa vende në Evropë si Estonia dhe Finlanda ndërsa është anëtarësuar në disa organizata të sigurisë si EFCA, CEPOL, INTERPA, AEPC.

Bazuar në përvojat ndërkombëtare dhe efikasitetin e treguar nga institucionet e ngjashme, AKSP synon të jetë një faktor kyç në krijimin e sigurisë publike në Republikën e Kosovës përmes ngritjes së kapaciteteve duke ofruar kompetenca të nivelit të lartë tek autoritetet e zbatimit të ligjit për t'iu përgjigjur sfidave që ndryshojnë vazhdimisht. *Pra të shndërrohemi në një Qendër e ekselencës i cili përpiqet për përmirësim të vazhdueshëm.*



## IX. OBJEKTIVAT

---

Strategjia zhvillimore e AKSP-së ka gjashtë **objektiva strategjike**, nga një për secilën fushë tematike të cilat zërthehen në **objektiva specifik**. Më poshtë është dhënë nga një përmbledhje për secilin objektiv strategjik, ndërkaq në planin e veprimit do të bëhet zërthimi i detajuar i tyre në aktivitete dhe **rezultate** konkrete.

Objektivat e përgjithshme strategjike janë:

### **1. Ofrimi i trajnimeve profesionale, avancuara dhe të specializuara për institucionet e sigurisë publike në përputhje me standardet e vendore dhe ndërkombëtare të akreditimit**

AKSP për realizimin e fushëveprimit të saj si institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike, në pajtueshmëri me objektivat e Strategjisë synon avancimin dhe modernizimin e fushës së trajnimeve.

Të gjitha proceset e parapara në këtë fushë do të realizohen konformë standardeve të akreditimit vendor dhe ndërkombëtar si dhe praktikave me të mira të Institucioneve relevante.

Bashkëpunimi me Institucionet e Sigurisë dhe partnerëve ndërkombëtar në identifikimin e nevojave trajnuese, koordinimin e projekteve të ndryshme dhe shkëmbimin e njohurive të reja do të shërbejnë si bazë për **hartimin dhe zhvillimin** e programeve trajnuese të niveleve të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve për sigurinë publike.

Përmes ofrimit të trajnimeve kualitative, aktiviteteve për aftësimin e zyrtareve të sigurisë si dhe akreditimeve vendore dhe ndërkombëtare tashmë të fituara, AKSP synon të ngritët në një Qendër të Ekselencës për ngritjen e kapaciteteve të reja profesionale, intelektuale që kontribuojnë në sigurinë publike në vend.

Objektivat specifik përcaktojnë caqet për zhvillimin e veprimtarisë trajnuese. Për secilin objektiv janë përcaktuar aktivitetet e nevojshme për arritjen e tij, ndërsa për çdo aktivitet janë përcaktuar rezultatet e pritshme në formë të treguesve të suksesit që shërbejnë për përcjelljen e progresit.

Në kuadër të këtij objektivi strategjik për arritjen e tij janë paraparë këto **objektiva specifike** :

*1.1. Zhvillimi i kurrikulave dhe ofrimi i trajnimeve sipas nevojave të ISP-ve dhe në bashkëpunim me Partnerët Ndërkombëtar;*

- 1.2. Ri-validimi i trajnimeve profesionale nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK);
- 1.3. Krijimi dhe Implementimi i politikave të përbashkëta me ISP-të;
- 1.4. Ri-akreditimi ndërkombëtar nga IADLEST;
- 1.5. Avancimi i shërbimeve multimediale në fushën e trajnimeve.

## **2. Fuqizimi i arsimit të lartë në siguri publike**

Viteve të fundit shumë vende perëndimore janë duke e trajtuar arsimin, veçanërisht arsimin e lartë, si një përcaktues shumë i rëndësishëm i sigurisë publike. Andaj me qëllim të përcjelljes së trendëve bashkëkohore në arsimimin e zyrtarëve të sigurisë konformë nevojave të Institucioneve të Sigurisë do të avancohen/krijohen programe studimore të cilat ndihmojnë ngritjen e kapaciteteve dhe sigurisë publike në vend.

Si nevojë e avancimit të kuadrove të Institucioneve të sigurisë, është paraparë themelimi i programit studimor master i cili do të ndihmonte Institucionet e sigurisë në krijimin e një sistemi menaxherial dhe kompetent.

Pra përmes këtij objekti synojnë të krijojnë masa inkurajuese më të mëdha për Institucionet e Sigurisë dhe rritjen e rezultateve mësimore të studentëve për tu ballafaquar me dukuritë negative.

Përmirësimi i standardeve të arsimit stimulon sigurinë publike në mënyrë direkte nëpërmjet efektit të tij në menaxhimin dhe produktivitetin e zyrtarëve të sigurisë publike andaj nevojitet të ndërtohen dhe të zbatohen politikat që synojnë rritjen e pjesëmarrjes në arsim në përgjithësi si faktor kyç i sigurisë publike.

Objektivat specifike përcaktojnë caqet e fuqizimit të arsimit të lartë. Për secilin objektiv janë përcaktuar aktivitetet e nevojshme për arritjen e tij, ndërsa për çdo aktivitet janë përcaktuar rezultatet e pritshme në formë të treguesve të suksesit që shërbejnë për përcjelljen e progresit

Në kuadër të këtij objekti strategjik për arritjen e tij janë paraparë këto **objektiva specifike**:

- 2.1. Zhvillimi i programit master në sigurinë publike;
- 2.2. Zhvillimi i mëtejshëm i programit studimor bachelor në siguri publike;
- 2.3. Avancimi i vazhdueshëm i mësimdhënies dhe metodave vlerësuese;
- 2.4. Administrim efikas dhe efektiv të studentëve.

### **3. Zhvillimi i profilit hulumtues në shërbim të sigurisë publike**

Veprimtaria kërkimore-shkencore është me interes të veçantë për AKSP-në, qëllimi i së cilës është puna hulumtuese sistematike që bëhet për kërkimin dhe zhvillimin e njohurive të reja, shfrytëzimin dhe zbatimin e tyre në praktikë në sferën e sigurisë publike.

Instituti do të jetë në shërbim të institucioneve të sigurisë publike duke zhvilluar aktivitete e tyre, si dhe duke krijuar inovacione të bazuara në nevojat që ato kanë. Projektet kërkimore do t'i plotësojnë kërkesat më të larta shkencore. Institutit për kërkimin dhe zhvillimin në AKSP do të fokusohet në dy fusha kryesore: **në fushën e arsimimit dhe të kërkimit dhe zhvillimit** në sigurinë publike. Hulumtimi dhe zhvillimi janë parë si procese të cilat merren me kërkime të aplikuara që mbështesin arsimimin në AKSP si dhe ISP-të, si dhe zhvillimin e vazhdueshëm të proceseve të mësimdhënies dhe të trajnimit në AKSP.

Fokusi i hulumtimeve do të jenë fusha e sigurisë publike, drejtësisë, ekonomisë ndërsa hulumtimet e aplikuara do të përqendrohen në projekte të cilat prodhojnë inovacione shoqërore të zbatueshme në lëminë e sigurisë publike.

Objektivat specifike përcaktojnë caqet e Institutit për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore. Për secilin objektiv janë përcaktuar aktivitetet e nevojshme për arritjen e tij, ndërsa për çdo aktivitet janë përcaktuar rezultatet e pritshme në formë të treguesve të suksesit që shërbejnë për përcjelljen e progresit.

Në kuadër të këtij objektivi strategjik për arritjen e tij janë paraparë këto **objektiva specifike**:

- 3.1. Funksionalizimi i Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim;*
- 3.2. Zhvillimi i projekteve hulumtuese në bashkëpunim me Agjencionet e Sigurisë Publike;*
- 3.3. Ngritja e kapaciteteve hulumtuese përmes publikimeve dhe konferencave.*

### **4. Implementimi i politikave të sigurimit të cilësisë sipas standardeve bashkëkohore**

Qëllimi këtij objektivi është që vazhdimisht nevojat trajnuese dhe arsimore të Institucioneve të Sigurisë Publike të freskohen përmes ofrimit të kurikulave trajnuese dhe programe studimore sipas kriterëve dhe standardeve të akreditimit vendore dhe ndërkombëtare.

Që nga viti 2014, është bërë progres i konsiderueshëm në sistemin e sigurimit të cilësisë në AKSP. Andaj me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm dhe implementimin e standardeve dhe kërkesave të Institucioneve të akreditimit dhe validimit nevojitet një dinamik e vazhdueshme e sigurimit të cilësisë.

Angazhimi në proceset e sigurimit të cilësisë (të brendshme dhe të jashtme) i mundëson akterëve njohje me të mirë të kualitetit, kualifikimeve dhe programeve të ofruara.

Kjo arrihet përmes vlerësimeve të vazhdueshme të proceseve dhe hartimit të raporteve me rekomandimet konkrete të orientuara në **sigurim** dhe **përmirësim** të shërbimeve dhe aktiviteteve.

Objektivat specifik përcaktojnë caqet e Implementimit të politikave të sigurimit të cilësisë sipas standardeve bashkëkohore. Për secilin objektiv janë përcaktuar aktivitetet e nevojshme për arritjen e tij, ndërsa për çdo aktivitet janë përcaktuar rezultatet e pritshme në formë të treguesve të suksesit që shërbejnë për përcjelljen e progresit.

Në kuadër të këtij objektivi strategjik për arritjen e tij janë paraparë këto **objektiva specifike**:

*4.1. Rishikimi i politikave të sigurimit të cilësisë;*

*4.2. Vlerësimi i programeve profesionale, trajnuese dhe arsimore.*

#### **5. Ngritja dhe përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, kapaciteteve infrastrukturore dhe proceseve të punës**

Përmes këtij objektivi, AKSP-ja synon plotësimin me burime njerëzore në vendet dhe kohën e duhur si dhe ngritjen e kapaciteteve ekzistuese konformë realizimit të mandatit Institucional. Ngritja dhe përmirësimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore është proces i cili garanton organizimin e punëtorëve, gjetjen e trajnimeve adekuate i cili ka për orientim krijimin e një infrastrukture të mirëfilltë njerëzore bazuar në aftësi dhe shkathtësi.

Proces tjetër i rëndësishëm i menaxhimit të proceseve është efikasiteti në punë, i cili synohet të arrihet përmes motivimi, ndarjes së detyrave, përcaktimit të afateve, kontrollit dhe përgjegjësisë.

Për ofrimin e shërbimeve cilësore nevojitet ngritja e kapaciteteve infrastrukturore më të avancuara për nëpunësit dhe vijuesit. Kjo strategji shërben si një plan për krijimin e një infrastrukture bashkëkohore dhe moderne si dhe digjitalizimin e shërbimeve në AKSP.

Objektivat specifik përcaktojnë caqet për ngritje të kapaciteteve, infrastrukturë dhe menaxhimin e punës. Për secilin objektiv janë përcaktuar aktivitetet e nevojshme për arritjen e tij, ndërsa për çdo aktivitet janë përcaktuar rezultatet e pritshme në formë të treguesve të suksesit që shërbejnë për përcjelljen e progresit.

Në kuadër të këtij objektivi strategjik për arritjen e tij janë paraparë këto objektiva specifike:

*5.1. Rekrutimi i numrit të nevojshëm të personelit mësimdhënës, hulumtues, trajnues dhe mbështetës;*

*5.2. Zhvillimi dhe avancimi i mëtejshëm i burimeve njerëzore;*

*5.3. Zhvillimi dhe avancimi i teknologjisë informative për menaxhimin e proceseve arsimore, trajnuese dhe proceseve tjera të punës;*

*5.4. Infrastrukturë përkatëse që i plotëson kërkesat arsimore dhe trajnuese;*

*5.5. Rritja e efikasitetit në menaxhimin e proceseve të punës.*

## **6. Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me palët e interesit vendore dhe ndërkombëtare**

AKSP ka për qëllim të forcojë dhe më tutje bashkëpunimin vendor dhe ndërkombëtar, një bashkëpunim afatgjatë dhe të qëndrueshëm për të përkrahur objektivat e saj strategjik. Tashmë janë iniciuar dhe paraparë bashkëpunime me disa Institucione relevante. Në fazat fillestare të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, personeli i Institucioneve respektive do të përpiqet të identifikojë fushat e interesave të përbashkët të hulumtimit dhe zhvillimit, shkëmbit të përvojave dhe mobilitete përmes të cilave mund të rriten kapacitetet . Po ashtu është e pritshme që bashkëpunimi të rezultojë në zhvillim të projekteve të përbashkëta të hulumtimit, shkëmbimin e informatave, organizimin e aktiviteteve të përbashkëta akademike dhe shkencore, siç janë seminarët, simpoziumet, konferencat, shkëmbimi i botimeve dhe materialeve të tjera të interesave të përbashkët.

Andaj synimi i AKSP-së do të jetë që përmes bashkëpunimit ndërkombëtar të krijoj partneritet me Institucionet relevante ndërkombëtare me qëllim të zhvillimit të projekteve të përbashkëta.

Objektivat specifik përcaktojnë caqet e bashkëpunimit vendor dhe ndërkombëtar. Për secilin objektiv janë përcaktuar aktivitetet e nevojshme për arritjen e tij, ndërsa për çdo aktivitet janë përcaktuar rezultatet e pritshme në formë të treguesve të suksesit që shërbejnë për përcjelljen e progresit.

Në kuadër të këtij objektivi strategjik për arritjen e tij janë paraparë edhe këto objektiva specifike si vijon:

*6.1. Fuqizimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me palët në interes vendore dhe ndërkombëtare si dhe realizimi i aktiviteteve të përbashkëta;*


*6.2. Aplikimi në programe dhe projekte të ndryshme dhe zhvillimi i mobilitetit të mësimdhënësve, studentëve dhe stafit administrativ;*

*6.3. Rritja e kredibilitetit përmes transparencës dhe besueshmërisë.*

## X. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI

AKSP është institucioni përgjegjës për zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e përmbushjes së strategjisë zhvillimore. Në kuadër të AKSP-së funksionon Departamenti për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore i cili sipas mandatit ligjor kujdeset për koordinimin e zbatimit të strategjisë zhvillimore si dhe monitorimin dhe vlerësimin e saj.

Hapat të cilët do të ndiqen për koordinimin e zbatimit të dokumentit strategjik janë:



**ZBATIMI** - Procesi i zbatimit të Strategjisë do të synojë përmbushjen e objektivave strategjike, atyre specifike dhe aktiviteteve. Strategjia zhvillimore e AKSP-së në përbërjen e saj ka edhe planin e veprimit i cili mbulon periudhën 2019-2022 dhe përmban aktivitetet, treguesit, afatet, njësit përgjegjëse për zbatim si dhe koston financiare. Plani i veprimit të strategjisë do të zërthehet në planet vjetore të AKSP-së dhe secila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve të parapara me këtë strategji.

**MONITORIMI** - Struktura për monitorimin e zbatimit të strategjisë zhvillimore të AKSP-së përbëhet nga treguesit e matjes të cilët janë vendosur në nivel objektivave specifike. Si tipare kryesore të monitorimit janë raportet të cilat hartohen në periudha të ndryshme si tremujore, gjashtëmujore, nëntëmujorë dhe vjetore. Monitorimi do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj. Ky proces duhet të përfshijë tregues të qartë të progresit të bazuar në raportet periodike të njësive si dhe të dokumenteve tjera relevante.

